

Kthim pergjigje nr. 192 Fri 10/2/2020 1:02 PM

To: qendra.respublica@gmail.com;

I nderuar Z. Matlija!

Në pergjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 192, në regjistrin e Kërkesave dhe Pergjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qëndror, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Referuar sistemit informatik [C@TS](#), subjekti “A.R.M.O” me NIPT J82916498D, ka detyrime të papaguara ndaj organit tatimor dhe rezulton në listën e subjekteve me barrë siguroese dhe hipotekore të publikuar ne web. Kundrejt këtij detyrimi janë marrë masat shtrënguese në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për sa kërkon informacion mbi vlerën e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, masat dhe vendimet marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në zbatim nenit 24 dhe 31 të Ligjit Nr.9920 Datë 19.05.2008 , Për Proçeduart Tatimore në RSH , përcaktohet kujt i ofrohet informacion mbi tatimpaguesin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tatimpaguesit.

Neni 24, ‘Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore; b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore; c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta; ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes; d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit; dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj; e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të vecantë.

Neni 31, E drejta për konfidencialitetin e të dhënave të tatimpaguesit; *1. Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.*

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: www.tatime.gov.al